

Pershendetje'

Me poshte gjeni pergjigjen e AKEP, mbi kerkesen e paraqitur per informacion.

Fillimisht sqarojmë që, bazuar në nenin 2, pika 1, të Ligjit nr. 9918/2008 i ndryshuar, AKEP nuk ka kompetencë ligjore të shqyrtojë përmbajtjet e komunikimeve elektronike, pra nuk ka kompetencë të shqyrtojë as përmbajtjet e faqeve të internetit.

Bazuar në gjurmën e), të nenit 15, të Ligjit nr. 9918/2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, AKEP u përcjell ISP-ve (ofruesve të shërbimit internet), shkresat e institucioneve ligjzbatuese, të cilat kanë kompetencë ligjore për të mbyllur/fshirë publikime online me përmbajtje të paligjshme.

Autoriteti kompetent për shqyrtimin e përmbajtjeve të paligjshme me anën e të cilave ushtrohen lojrat e fatit, është Autoriteti i Mbikqyrjes së Lojërave të Fatit. Që nga hyrja në fuqi e ndryshimeve në Ligjin nr. 155/2015 "Për lojrat e fatit në Republikën e Shqipërisë" (01.01.2019), ky Autoritet ka kërkuar mbylljen e aksesit për rreth 8500 faqe/domaine, përmbajtja e të cilave shkel Ligjin nr. 155/2015 dhe AKEP i ka përcjellë këto kërkesa tek ofruesit e shërbimit internet (ISP-të).

Pra, bazuar në nenin 15 të sipërcituar, bllokimi i aksesit në internet i këtyre faqeve/domaineve, bëhet nga ISP-të dhe jo nga AKEP. Kësisoj në Republikën e Shqipërisë, këto faqe/domaine, nuk mund të aksesohen.

Domaini bet365.com ka qenë pjesë e listave të ardhura në AKEP dhe është dërguar për mbyllje tek ISP-të.

Me respekt'